



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5367/2024
Data: 19.06.2024

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e pestë -V- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.05.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkyetar i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtore për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtore për Arsim), Rezart Memeti (Përfaqësues i OSB-së), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Kërkesa e z. Endrit Curri për ndërrim destinim të pronës.
3. Kërkesa e z. Faton Curri për ndërrim destinim të pronës.
4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
5. Raporti i tubimit zgjedhorë për përzgjedhjen e këshillit lokal të Hanit të Elezit, Uji Thartë, Lagjja e Re, Laç dhe Dimcë.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rrith procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Kërkesa e z. Endrit Curri për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë diçka të veçantë nuk kam për me shtuar.

Zaim Bela thekson:- në materialin që na është përcjellë bëhet fjalë për klasën e pestë dhe të gjashtë dhe më herët ka mundur edhe përmes drejtorive klasën e pestë dhe të gjashtën me bërë ndërrim destinimin.

Refet Kalisi thekson:- ku gjinden këto prona për të cilat është kërkuar ndërrim destinimi.

Abduraman Bushi thekson:- klasa e pestë dhe e gjashtë bëhet përmes kuvendit të komunës ndërsa klasa e shtatë dhe tetë bëhet përmes drejtorisë. Sa i përket vendin bëhet fjalë për te kufiri.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU KËRKESA E ENDRIT CURRI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

3. Kërkesa e z. Faton Curri për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- është e njëjta procedurë por nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU KËRKESA E FATON CURRI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- ne kemi përgatitur një informatë për gjendjen në mjedis për vitin 2023. Në informatë janë paraqitë normat e cilësisë së ajrit sipas udhëzimit administrativ për parametrat e azotit dyoksidit të sulfurit monoksidit të karbonit si dhe ozonit. Në informatë është paraqitur edhe tabela e indeksit të cilësisë së ajrit sipas standardeve të bashkimit evropian. Informata përmban rezultate cilësisë së ajrit të stacionit të monitorimit që është i vendosur te shkolla fillore dhe është edhe krahasimi i rezultateve të vitit 2022. Sa i përket ndotjes dhe ujit nuk ka ndryshime në krahasim me vitet paraprake por në komunën tonë mbetet si problematike hedhja e mbeturinave të ngurta vend e pa vend në mungesë të deponisë për mbetjet e ngurta si dhe derdhja e ujërave të zeza në lumin Lepenc dhe përrockat e komunës. Në informatë janë paraqitur edhe aktivitetet e komunës siç është ndërtimi i parkut të qytetit, rregullimi i hapësirës publike te rruga Lepenci. Mbjellja e 20 000 fidanëve në zonën kadastrale në Seçishtë te Kodra e Shullanit. Rregullimi i hapësirave publike te kompleksi memorial “Bllaca 99”. Janë paraqitur edhe aktivitete të tjera si inspektimet, gjobat e regjistruese. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- e lexova raportin por ndotje në Han të Elezit ka sepse të njëjtat parametra na përcillen për çdo vit. Është shënuar në raport mbjellja e 20 000 fidanëve por a ka dal dikush me parë gjendjen e tyre se a kanë zënë të gjitha sepse disa kanë dështuar për shkak të përkujdesjes.

Nexhmedin Daci thekson:- në informatë askund nuk qëndron se nuk ka ndotje por mundeni me lexuar faqen pesë që potencon se edhe pse vlerat e regjistrues së ajrit nga SO₂, CO, NO₂, O₃, PM_{2.5} dhe PM₁₀ sipas rezultateve nga stacioni për monitorimin e cilësisë së ajrit (i vendosur në oborrin e shkollës filllore) janë brenda limiteve dhe standardeve të përcaktuara me U/A 02/2011 (vlerat mesatare vjetore) na besojmë thellësish se këto rezultate nuk pasqyrojnë drejtë nivelin e ndotjes i cili ekziston në pjesë të caktuara të qytezës e sidomos në lagjet në afërsi të Sharrcem dhe magjistrales Prishtinë-Shkup (pjesa verilindore e Hanit të Elezit). Sa i përket pishave mirëmbajtje nuk kanë dhe varen prej reshjeve të natyrës për shkak se është sipërfaqe e madhe dhe e dini se çfarë kapaciteti ka komuna. Disa prej tyre kanë dështuar sipas informatave që i kemi nga drejtoria e bujqësisë por unë mendoj që drejtori për bujqësi ka kryer një punë të madhe një aksion që nuk e kemi parë deri më tani për shkak se me u mbjellë 20 000 mijë fidanë nuk është punë e vogël por ka qenë një angazhim i veçantë i drejtorit dhe i vullnetare të asaj pjese. Problemi ka qenë se fidanet kanë qenë të serrave dhe kur dalin në natyrë e kanë problem por do të shikohet mundësia për me i mbjellë përsëri, ndërsa për mirëmbajtje nuk ka kapacitet komuna.

Sherif Berisha thekson:- pse nuk e shihni të arsyeshme me pasur monitorim nga niveli komunal pra me pasur një person përgjegjës të caktuar për atë punë. Unë e kam kërkuar por në material nuk e keni planifikuar a e parashihni në të ardhmen me pasur

Nexhmedin Daci thekson:-ne e kemi hartuar planin lokal të veprimit dhe aty është e paraparë vendosja e dy monitorëve për matjen e cilësisë së ajrit por duhet të i shikojmë mundësitë buxhetore. Edhe në plan zhvillimorë e kemi paraparë monitorimin e cilësisë së ajrit në dy apo tri lagje të komunës së Hanit të Elezit.

Zaim Bela thekson:- ne e dimë çështjen e klimës sepse sa kam qenë drejtorë kam mbjellë dy herë mes Fshatit Krivenik dhe Gorancë dhe kanë zënë ato fidane por vera e nxeh të dhe janë zhdukur, pastaj përsëri e kemi përsëritur mbjelljen e katër mbëdhjetë hektarëve dhe në fund e kanë vërejt se nuk munden me i qëndruar kësaj klime. Sa i përket asaj zonës që e keni bërë mirë që është bërë me punë vullnetare dhe nuk është shpenzuar shumë, mirëpo pranvera ka qenë me të reshura dhe mbi nëntëdhjetë përqindë me zënë por kur të fillon nxehësia kanë me dështuar. Ajo punë është bërë se fidanet i keni marr pa pagesë puna është bërë pa mjete financiar se të ishte bërë me buxhet të komunës sigurisht që kishte pasur shumë debat këtu por ndoshta pak ka qenë neglizhenca e Kryetari dhe e drejtorit sepse ka mundur me hyrë në plan vjetorë sepse edhe territori i Krivenikut që është mbjell me mbikëqyrje tri vjeçare se tenderin e ka marr dikush tjetër dhe ka mundur me i përfshirë edhe këto por ndoshta neglizhencë ka qenë për shkak se kanë mundur me u mbjell me punëtorët që i ka paguar agjpcioni pyjorë me mbikëqyrje tri vjeçare. A i keni parë fidanet që janë mbjell me punëtorë dhe a janë në gjendje më të mirë për shkak se të njëjtat fidane kanë qenë.

Abduraman Bushi thekson:- kërkesën kur e kam parashtruar nuk e kam bërë që komuna dhe fshati me bërë mbjelljen por agjensioni për shkak se kanë qenë të parapara me u pyllëzuar tridhjetë hektarë dhe në kontaktet që i kam pasur me përfaqësuesit e agjensionit ju kam rekomanduar që gjashtëmbëdhjetë hektarë me i lënë në vendin e quajtur Zhenë dhe katërmëbhjetë me i përfshirë në fshatin Seçishtë dhe drejtori nuk i k përfshirë por na i ka siguruar fidanet dhe na është dashur me i marr dhe me i kryer sepse kërkesa jonë dhe e fshatit nuk ka qenë që na me pyllëzuar por agjensioni mirëpo ata nuk kanë dashur. Fidanet ku i ka mbjellë agjensioni nuk kam qenë me i shikuar për shkak rrugës se është e dëmtuar por fidanishtja kur i ka furnizuar fidanet u a ka dhënë me dhe ndërsa tonat të zhveshura prej dheut sepse un i kam kërkuar me module por nuk më kanë furnizuar me module ashtu siç ja kanë dhënë kompanisë private. Për shkak se kompaninë e kanë furnizuar me pisha me module mundësit janë më të shumta për me zënë.

Zaim Bela thekson:- është mirë me bërë kërkësë në agjensioni pyjorë për rimbjellje që të njëtin vend me paraparë edhe një herë dhe agjensioni ne ta bënë mbjellje sepse tri vite po i jepin me mbikëqyrje.

Sherif Berisha thekson:- a ka ndërmarr diçka komuna për çështjen e pishave që janë në pjesën e fshatit Gorancë dhe Krivenik për shkak të sëmundjes që ju shfaqur.

Abduraman Bushi thekson:- sa i përket pishave në fshatin Gorancë dhe Krivenik nuk jemi kompetentë por e kemi njoftuar drejtorinë regionale dhe kanë potencuar që nuk kanë kapacitet për këtë çështje . Prej se jam drejtor për bujqësi për çdo vit e kam njoftuar drejtorinë regionale për këtë çështje. Unë kam parashtruar kërkesa për pyllëzimin e pesëmbëdhjetë mijë fidaneve, mirëpo draft planin nuk ma kanë dërguar por në takimet që i kemi pasur me përfaqësuesit e Ministrisë përkatëse dhe me regionin na kanë premtuar që do të na furnizojnë por ende nuk kemi ndonjë konfirmim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Raporti i tubimit zgjedhorë për përgjedhjen e këshillit lokal të Hanit të Elezit, Uji Thartë, Lagija e Re, Laç dhe Dimcë.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- pasi që ka dhënë dorëheqje kryetari i këtij këshilli së bashku me komisionin e kemi mbajtur takimin dhe kryetarë i këtij këshilli eshtë zgjedhur z.Ali Axhami.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj përgjigje me shkrim nga drejtoresha për Kulturë , Rini dhe Sport a është përfituese e subvencioneve në sport, kulturë dhe rini. Si eshtë liruar profesori në pushim dhe pse edhe dy muaj pas merr pagë. Drejtorit të arsimit i drejtohem se çfarë raporte keni me drejtorët e tjerë , a keni konflikte ndërmjet juve brenda për brenda. Si drejtor i drejtorisë për arsim me çfarë cilësie keni shkuar në Barcelonë së bashku me kryetarin e komunës. A mendoni që i keni kryer punët e drejtorisë që keni kërkuar me t'i hequr përgjegjësitë dhe jemi ne ato të cilët ta kena votuar ndryshimin dhe nga arsimi tu ka ndarë kultura, rinia dhe sporti dhe po keni kohë me shëtitur ku gjendja nëpër shkolla është e mjerueshme, pa ujë, pa projektorë e llaptop për mësimdhënës por vetëm me pretime punësimi . Në bazë të cilit Ligj apo rregullore komunale është bërë subvencionimi i bizneseve në komunën e Hanit të Elezit dhe besoj se e keni parë që një zyrtarë komunal i cili punon në drejtori të financave është përfitues i këtij granti. Sa projekte i keni bërë deri më tanë me projektues për shkak se paraqiteni që sikur është puna juaj, e te parku “Isa Berisha” e në fund del krejt tjetër edhe pse ma herët e kam parashtruar këtë pyetje dhe këtë projekt e ka bërë “Alba Grup”. Pse ka dështuar procedura e IPA fondevë ku qëndron problemi, a nuk po dini me përgjedhur menaxherin e projektit me kritere apo pse po dështon kjo procedurë . A kanë leje ndërtimore këto objekte në katin e pestë dhe të gjashtë që shihen nga komuna dhe kërkoj me shkrim lejet dhe planet ndërtimore që janë dhënë. Për ekzekutivin e kam një pyetje të drejtë për drejtë a mundeni me na treguar se cili projekt në këtë vit është në realizimi dhe që krenoheni me të jashtë se gjoja që punët janë duke ju shkuar mirë . Kam një shqetësim për të cilin kërkojë nga prindërit që fëmijët mos t'i dëmtojnë ato të mira të cilat janë projekte që janë zhvilluar si në të kaluarën dhe në të tashmën, ne ta ruajmë ambientin në të mirën e përgjithshme e jo ta shkatërrojmë atë siç kemi parë shkatërrime të paçeve, nëpër shkolla dhe te çerdhja. Propozoj që në ditët e kulturës të shtrohet një darkë për gjitha kategoritë e dalura nga lufta dhe kjo të bëhet traditë për çdo vit gjatë mbajtjes së festivalit.

Hisni Luri thekson:-sa i përket profesorit nuk më ke kërkuar material po përsëri po e shpjegojë se çdo punëtorë edhe në arsim ka të drejtë të kërkojë pushim pa pagesë dhe atë e ka kërkuar profesori në fjalë . Pushimin pa pagesë e ka kërkuar për një kohë të caktuar gjë që i bien që e ka pezulluar vendin e punës por ka të drejtë ta kërkon edhe pushimin mjekësorë dhe paga duhet mi vazhduar se ka marr njëzet ditë pushim mjekësore. Ligji i Punës nenë katërdhjetë në bazë të kërkuesës së të punësuarit punëdhënësi mund t'i lejojë që i punësuari të mungojë nga puna por pa kompensim të pagës, e ne në arsim e kemi pak ma specifike kur është në pyetje për Ligjin e Punës për shkak se ne u japim vetëm këtyre rasteve pezullim të punës e që është ushtrimi në pozicionet politike për studime jashtë shtetit apo ngritjet profesionale dhe për rastet shëndetësore që dokumentohen e që në këtë rast ka kërkuar pushim mjekësorë për shkak se dokumentet i ka sjellë ashtu e unë nuk jam prokurorë që me hetuar vazhdimisht se ka mund të shkon ai dhe unë kam vepruar në bazë të Ligjit dhe dokumenteve që na i ka sjellë dhe kush do që të kishte qenë në pozicionin tim kishte me qenë i detyruar për me respektuar Ligjin dhe unë vetëm Ligjin e kam respektuar. Raportet me drejtorët e tjerë i kam të shkëlqyeshme po ashtu edhe me drejtorët e shkollave kam raporte të mira. Në Barcelonë kemi shkuar si të ftuar prej organizatës Alda dhe së bashku me Kryetarin e Komunës kemi marr pjesë në festivalin e Aldës në asamblenë e përgjithshme mbi ndikimin global të demokracisë lokale ku pjesëmarrësve u epet mundësia që të eksplorojnë për nivelet e qeverisjes lokale. Kemi qenë të ftua si të vetmit institucion nga Kosova pasi që në vitin 2022 kemi qenë përfitues të çmimit për qeverisje lokale nga organizata Alda. Është bërë punë e mirë që e kemi ndarë drejtorinë e kulturës se nuk kam përgjegjësi të mbajtjes së festivalit, nuk kam përgjegjësi tjera që i kanë takuar sportit dhe përgjegjësi tjera që i ka kultura. Sa i përket punës të kulturës e që po i ndërlidh edhe nëpër shkolla nuk po besoj që janë ashtu për shkak se jemi në dhjetëshen e më të mirave shkolla në Kosovë e që projektorët janë material hargjuesë por nuk kemi dashur me investuar në projektorë pasi që kemi planifikuar të bëhen me tabela Smart dhe për vitin e ardhshëm nëse do të kemi buxhet planifikimet e drejtorisë së arsimit janë në këtë teknologji. Ka pasur raste që kanë mbetur pa ujë dhe është dashur me bërë zvogëlimin e orëve për disa minuta për shkaqe të sigurisë, mirëpo nuk ka qenë aq emergjente sa që të përmendet në Kuvend për shkak se dy apo tri ditë ka pasur reshje të shiut dhe ka pasur raste që edhe viteve të tjera ka ndodhë kjo, e që nuk është arsy që me i përmendur edhe konkurset sepse konkurset zhvillohen prej udhëheqëses për burime njerëzore zhvillohen konkurset dhe nga dita e parë që kam ardhur këtu e kam respektuar ligjin e fundit që është.

Sherif Berisha thekson:-ju potenconi që në bazë të ligjit por zotëria punon në dy vende të punës dhe a është në rregull që ai të punon atje dhe vendi i punës është i hapur dhe ju thoni që me konkurse jemi në rregull po përsëri ka ardhur personi që ju ka premtuar. Sa i përket Barcelonës çka na keni sjellë të re sepse shkohet shumë në takime zyrtare dhe ku është mendësia që na i keni sjellë se ka qenë Kryetari dhe ju në këtë rast prak janë përfitimet.

Hanumshahe Dibrani thekson:- te rruga Ismail Qamajli kur do të fillon rregullimi i përroit. Pasi ka përfunduar regjistrimi i popullsisë a ka pasur ndonjë pa rregullsi. Për shkak të shpejtësisë së vetravë në fshatin Seçishtë nga banorët ka kërkesa që të vendosën pengesa për shkak se fëmijët janë në rrezik. Ku keni mbërrri me vendosjen e serrave për shkak se mendoj që është shkuar pak me vonesë.

Sevdi Dernjani thekson:- ato të cilat i përmendi z. Sherif Berisha gjatë diskutimit të tij nuk qëndrojnë për shkak se te IPA fondet janë disa procedura të cilat duhet të ndjeken që për momentin lënda ka qenë në OSHP dhe është kthyer prej OSHP-së dhe është në procedurë të prokurimit , ndërsa çështja e problemit të drejtorëve është shumë e ulët me u diskutuar në Kuvend se problemet mundën me qenë edhe në familjet tonë e lej mo në mes drejtorëve dhe zyrtarëve por janë probleme që i takojnë ekzekutivit të komunës . Nuk e dimë që ka ndonjë zyrtarë që ka përfituar prej subvencioneve por unë mendoj që janë pretendime të pa vërteta. Sa i përket regjistrimit të popullsisë nuk kemi ende ndonjë komunikatë zyrtare prej organeve përkatëse por procesi ka shkuar në rregull.

Sherif Berisha thekson:- në foto është zyrtari për financa që ka përfituar pra është z.Selver Shkreta për pyetjet që i përmende është shumë me vend se pse mos ta dimë ne se çka po ndodhë brenda komunës.

Majlinda Kaloshi thekson:- subvencionet janë ndarë në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe të Ligjit për Financat Publike dhe në bazë rregullores komunale për kushtet kriteret për ndarjen e subvencioneve që është miratuar me datë tridhjetë e një maj të vitit dy mijë e njëzet e dy. Përfitues zyrtarë komunal nuk por ndoshta familjarë të tyre munden me qenë dhe nuk mundemi me ja ndaluar dikujt mënyrën e aplikimit. Nuk ka pasur konflikt interes i për shkak se zyrtari në fjalë nuk ka qenë pjesë e komisionit dhe zonja në fjalë i ka pasur dokumentacionet në rregull. Sa i përket realizimit të projekteve si drejtori nuk marrim merita të dikujt tjetër që e ka kryer punën e që në këtë rast është drejtoria e urbanizmit por realisht e kemi bërë promovimin e një punës së mirë të cilën e ka kryer drejtoria së bashku me zyrtarë që i ka në kuadër të drejtorisë.

Abduraman Bushi thekson:-deri më tanë afër gjashtëdhjetë serra janë montuar dhe sipas bisedave që i kam kanë potencuar se nëse koha është e mirë deri të martën do të përfundon. Arsyet se pse janë vonuar kanë që në kushtet klimatike.

Zaim Bela thekson:- kërkoj me shkrim përgjigje na zyra ligjore për shkak se kam dëgjuar për aktgjykimet e gjykatës të cilat vijnë këtu për disa janë të rregullta aprovojen e për disa shkojnë në gjykatë të apelit. Komuna së bashku me zyrtarët e qeverisë kanë postuar shpalljen për dëmet që janë shkaktuar prej breshrit dhe bëjë apel prej komunës që si komunë me i kryer punët e tonë për shkak se ne i dimë kapacitet sa i ka komuna. Sot përfundon aplikimi dhe nga dita e nesërme me i formuar komisionet dhe me dal në teren me i bërë raportet dhe me hequr barrën prej vetit. Përrugën te kufiri a është dashur me i hequr shitoret dhe me bërë park apo është tu u punuar në atë rrugë për shkak se ka pasur probleme për me zgjeruar rrugën. Serrat janë vonuar dhe mirë që u vonuan se breshëri na i dëmtoj tjerat që janë vendosur

Resul Suma thekson:- në çdo kuvend dhe në KPF sjellja e drejtorëve dhe e jotja si nënkyetarë i komunës nuk është e duhura me pyetjet e asamblistëve dhe në rast që nuk i respektoni asamblistët dhe nëse nuk e respekton z.Sherif Berisha që është më i vjetër se unë nuk je tu më respektuar as mu dhe askënd tjetër . Kërkoj nga ju që përgjigjet me i bërë më pak me arrogancë sepse këtu jemi te përfaqësuar popullin dhe interesin e komunitetit . E përkrahi propozimin e z.Sherif Berisha për ditët e kulturës dhe duhet të bëhet. Projekti në fshatin Krivenik që është duke i kryer punimet KEDSI a ka pasur me përfunduar në shkurt, a është përgjegjësi e KEDSIT që nuk ka përfunduar projekti deri tash e një shtylle elektrike ka rënë dhe ka mundur me shkaktuar dëmtime të mëdha.

Xhevahir Dernjani thekson:- me datë 21.05. 2024 ka pasur reshje të shiut dhe breshrit, drejtoria për shërbime publike së bashku me nënkyetarin e komunës tërë kohën kanë qenë në lëvizje duke u njoftuar më afër me qytetarët. Projekti i serrave gati se është në përfundim. Kompania pastrimi ka bërë pastrimin e terrenit që është shkaktuar na shiu dhe breshëri.

Erblin Meliqi thekson:- gjatë muajit në të cilën jemi drejtori i urbanizmit ka dal në teren së bashku me zyrtarët përçatës për çështjen e rregullit të hapësirës për te varrezat e lagjes Meliq dhe nga kjo follore falënderoj Kryetarin e Komunës dhe drejtorinë përçatëse të cilët ju kanë përgjigjur kërkesat të banorëve të asaj lagje.

Sevdi Dernjani thekson:- sa i përket reshjeve së bashku me drejtorin e shërbimeve publike dhe kemi vëzhguar me kujdes gjithë situatën . Është formuar komisioni dhe drejtoresha e administratës e ka organizuar administratën dhe kërkesat janë duke u bërë. Komuna për shkak të mundësive buxhetore nuk mundet me i kompensuar dëmet por jemi ty mbledhur aplikimet dhe do të dërgojmë në nivel qendrorë për ndonjë kompensim eventual. Te rruga Adem Jashari në asnjë moment nuk është ndaluar puna por ka vazhduar gradualisht dhe në ka dalur një paparashikim dhe kemi nxjerr një procedurë tjetër të prokurimit dhe pa u përfunduar procedura e prokurimit nuk mundemi me vazhduar me projektin në fjalë e që këto ditë do të përfundon procedura dhe do të vazhdohet me projektin në fjalë . Arrogancë dhe qasje të keqe në asnjë moment nuk kemi shprehur kjo është një pretendim apo ndoshta çdo herë keni dëshirë që me i bërë çështjet madhore para se me u futë në kuvendë por këtu nuk ka pasur asnjë herë arrogancë as qasje negative. Disa pyetje që i parashtrojë z.Sherif Berisha janë të pakuptimta për mu dhe nuk ke çëshje e arrogancës por e një kundër replikë. Ne jemi tu bërë shumë për komunitetin dhe ju ftojë jo vetëm një herë në muaj dhe me bërë qasje të mëdha por ju ftojë me dal në teren ashtu siç i kemi pasur fatkeqësitë natyrore dhe me i verifikuar ata

qytetarë të cilët janë të prekur prej këtyre gjërave dhe me mbështetur ekzekutivin sepse je pjesë e sajë. Për ndërtimin e një rrjeti të ri në fshatin Krivenik kemi bërë kërkesa të vazhdueshme dhe kërkesa jonë është marr parasysh nga kompania KEDS dhe ka filluar me montimin e shtyllave. Kompania është private dhe qytetari duhet me u marr direkt me të por shqetësimet më madhore që ja ka shkaktuar kompania duhet me i adresuar në komunë dhe komuna me shkresë zyrtare mundet me përcjell në organet përkatëse. Kërkesa zyrtare nuk kemi pasur prej fshatit përvëç njoftimeve për ndërprerje të rrymës .

Resul Suma thekson:- unë e potencova si paralajmërim se nëse donë ty dhe drejtorët ne po e lëshojmë sallën dhe ju bisedoni në mes veti, propozoni dhe bëni projekte, lëvdrone njëri tjetërin por unë e them të që e thonë qytetarët dhe çka e mendojë edhe unë. Si asamblistë mundem me të bërë pyetje më banale ty ke përgjegjësi me mu përgjigjur qoftë drejtë për drejtë qoftë me shkrim. Nëse jemi tu ju penguar dhe tu bërë pyetje palidhje dhe po vijnë një herë në muaj e ju po punoni shumë dhe nëse është kështu ne po e lëshojmë dhe ju rrini veç vetë. Unë kam kontakte me banorët e fshatit Krivenik dhe rregullisht jam në kontakte me qytetarët se ata më kanë sjell mu këtu ku jam dhe unë ata i përfaqësoj. Kërkesa ka pasur por edhe postime në fesbuk ka pasur. Parku është tu dëmtuar shumë dhe policia është e njoftime pse nuk merr masa me i dënuar. A është e vërtetë që kompania ETC nuk është e regjistrime për tatim në pronë.

Kryesuesi thekson:- është fakt që këto diskutime nuk duhet të bëhen në kuvend por është e drejtë e asamblistikët me i parashtruar pyetje drejtorit por drejtori nuk duhet e i marr pyetjet personale dhe është e drejtë e tij me u përgjigjur në pyetje aq sa ka mundësi dhe mënyra siç po kritikohen dhe replikohen nuk është e drejtë se asamblisti nuk vjen për çdo ditë në punë është i lidhur drejt për drejtë me qytetarin dhe ka kërkesa dhe ankesa por besojë që nuk është e mirë me vazhduar në këtë formë. Ka forma edhe tjera më të rënda se kur diskutohet një problem apo një çështje drejtorët shkojnë në atë mënyrë që me ta cenuar të drejtëndëndoshta edhe me anë të padisë me ja ndalë një asamblisti zërin por un mendoj dhe vlen për gjithë asamblistikët se e drejta e juaj është me përfaqësuar qytetarin se aty ku është për të mirën e qytetarin është mirë me diskutuar por jo me fajësuar drejtorin apo kryetarin por ne duhet të punojmë për interes të qytetarit.

Sevdi Dernjani thekson:- edhe unë mendoj që çdo asamblistë duhet me shprehur mendimin e lirë që populli ua ka besuar si ekzekutiv kemi për detyrë për me i mbrojtur të drejtat , shembull ni asamblistikë pretendon diçka të pavërtetë e në këtë rast u potencuan shumë të pa vërteta të cilat i vërtetojë edhe drejtoresha dhe u alodu diçka që asamblisti z. Resul Suma po e shprehë para asamblesë komunale dhe para qytetarëve të komunës, mirëpo në asnjë moment nuk kam shprehur mungesë respekti te asnjë drejtorë por edhe te asnjë asamblistikë e në këtë rast as ndaj z. Resul Suma por thjeshtë e dhash një mendim që mundet mos me të pëlqyer por nuk është mungesë e mos respektit dhe nuk duhet të përzihen gjërat. Për atë që po e përmend që duhesh me dal tri apo katër herë që duna me dal prej sallës prej një replike që potencova e ke shumë gabim se nuk duhesh me lëshuar një post që ta ka dhënë dhe ta ka besuar qytetari.

Refet Kalisi thekson:- kërkesë i kam parashtruar në muajin e kaluar drejtorisë së urbanizmit për legalizimin e shtëpive dhe kam kërkuar se sa shtëpi janë legalizuar në Han të Elezit pra ekonomi familjare dhe objekte të tjera. Nuk u pajtova me nënkyetarin e komunës dhe me drejtoreshën për zhvillim ekonomik që potencuan për ndarjen e subvencioneve se nëse unë jam drejtor dhe bashkëshortja ime merr subvencione është konflikt interesi .

Nexhmedin Daci thekson:- lista e projekteve kapitale është miratuar vitin e kaluar qytetarët duhet me parashtruar kërkesë apo kur të mbahen dëgjimet publike me paraqitur propozimet e tyre dhe propozimet i përcjellim në kuvend për shqyrtim dhe miratim . Projektin e parkut 95% e ka bërë sektorin i urbanizmit , po ashtu projektin e ka ndihmuar edhe drejtoresha për zhvillim ekonomik por me atë projekt kur kemi aplikuar për grantin e performancës është kërkuar që projekti me qenë i vulosur prej ndonjë kompanie të licencuar dhe kompania Alba Grup na e ka kryer shërbimin pa asnjë lloj pagese . Projekti i IPA fondevë është shtyer deri në muajin qershor për shkak se problemet i ka pala e Maqedonisë sepse atje janë dy pal Ministria dhe një OJQ të cilët ende nuk janë marr vesh se si kanë me ndarë buxhetin në mes tyre , ndërsa prej anës sonë nuk ka ndonjë problem përvëç procedurave të prokurimit të cilat besoj se në këtë javë do të kryhen. Sa i përket procedurave të legalizimit do të jap përgjigje me shkrim. Çështja e mirëmbajtjes së parkut nuk është kompetencë e imja por të gjithë e shohim se çka po ndodhë aty dhe është për me u habitur për ato shkatërrime që po ndodhin policia është në dioni.

Majlinda Kaloshi thekson:- në rregulloren komunale nuk shënon në asnjë nen që përjashtohen familjarët e zyrtarëve komunal dhe kjo rregullore është miratuar në asamblenë komunale dhe nuk është konflikt interes i për ndonjë të afërt nëse personi në fjalë nuk është pjesë e komisionit vlerësues.

Kryesuesi thekson:- është fakt që në rregullore nuk shënon por nuk duhet të ju bëni thirrje individëve që me aplikuar dhe pse është vazhduar afati.

Majlinda Kaloshi thekson:-si drejtori nuk e kemi ftuar askënd për me aplikuar dhe qytetarët i kemi ftuar përmes thirrjes publike që e kemi bërë në vebfaqën komunale dhe i kemi pasur njëmbëdhjetë aplikuesë. Arsyja e shtyrjes së afatit është se në fillim kemi pasur shumë pak aplikuesë dhe kemi dashur me ju dhënë edhe pak kohë për me i përgatitur dokumentacionet në fjalë.

Kryesuesi thekson:-ne dimë realitetin edhe pse para qytetarëve mundoni me dalë perfekt edhe ne që po bisedojmë e dimë një realitet krejt tjetër pavarësisht çka shënon rregullorja.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket objektit të ETC-së për momentin nuk kam ndonjë përgjigje.

Abduraman Bushi thekson:- për pos faktorit klimatik nuk ka ndonjë arsy e tjetër për çështje të serrave sipas planit është dashur me filluar me 15 mars por nëse merren për bazë kushtet klimatike nuk kanë qenë të mira.

Sherif Berisha thekson:- sa i përket ekzekutivit nuk është hera e parë e sjelljeve arrogante por ne të mbetet në ndërgjegjejen e tyre dhe ne ta vlerësojnë qytetarët. Te zyra ligjore kam paraqitur një kërkesë dhe kanë kaluar gjitha afatet por ende nuk kemi marr përgjigje. Cili projekt është duke u realizuar në këtë vit.

Sevdi Dernjani thekson:-është mirë me specifikuar pyetjen ku potencohet se cili projekt është tu realizuar, mirépo gjatë vitit të kaluar e kemi bërë një projekcion buxhetorë dhe nëse përmenden cilat projekte kanë me u realizuar për vitin 2024 është një listë e gjatë dhe nëse mendon se cilat projekte janë tu realizuar gjatë kohës që jemi tu diskutuar dhe nëse mendoni për periudhën maj korrik është drejtoria e urbanizmit që për projekte kapitale mundet me na dhënë përgjigje. Jashtë projekteve buxhetore kemi nxjerr projekte në shumë rreth një milionë e pesëqind mijë euro tu e përfshi rrugën e Paldenicës, rrugën Adem Jashari , rruga Krivenik – Gorancë , është bërë pajisja me gjeneratorë në fabrikën e ujit, janë dhuruar pajisje në QKMF , janë bërë me mijëra punë të cilat na i kemi promovuar por ndoshta ju nuk i keni pa . Në vazhdimësi jemi në kontakt me organizata të huaja dhe me nivelin qendrorë por jemi tu e pasur një vështirësi të bërit politikë prej nivelit qendrorë nuk është që kemi ndonjë mbështetje të madhe përveç Ministrisë së Infrastrukturës zëvendësministrit Durmishi dhe në asnjë Ministri tjetër nuk kemi gjetur mbështetje. E kemi humb grantin e performacës për shkak se Ministri Elebert nuk ka mundur me organizuar takim të cilin na ja kemi shpjeguar me rekomandim të auditorit që potencon që mjetet të cilat janë alokuar janë të muajit dhjetorë dhe nuk mundet me u zhvilluar asnjë procedurë e prokurimit.

Xhevahir Dernjani thekson:- rruga Gafurr Loku , rruga e Shkollës pastaj projekti i parkut është kërkesë e kryetarit të këshillit të fshatit Paldenicë që me u realizuar si projekt.

Resul Suma thekson:- gjatë planifikimeve për vitin 2024 e kemi pasur edhe një projekt që ka qenë i fundit dhe e di që në këtë vit nuk ka kushte financiare për me u realizuar por un me disa bashkë vullnetarë të tjerë e kemi realizuar një projekt ideorë për rrugën Hani i Elezit-Dimcë dhe pasi i kam bërë kopje po ja dorëzoj nënkyetarit të komunës dhe drejtorit të urbanizmit.

Hyriete Isufi thekson:- e përkrah propozimin e z.Sherif Berisha për darkën për veteranët.


Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30`.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

